

AKT-THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"DBI AUDIO & VISUAL ALBANIA" shpk

Sot, më datë 30.12.2024 hartohet Akti i Themelimit i Shoqërisë

"DBI AUDIO & VISUAL ALBANIA" shpk

Me anë të këtij dokumenti, të hartuar në 4 (katër) kopje origjinale,
ortakët e shoqërisë:


Shoqeria: **DBI AUDIO & VISUAL I.K.E**

Me nipt 801233932 , me adresë
në rruga Leoforo Kifisu nr. 87,
T.K 12241 Athinë, Greqi.

Përfaqësuar nga z. Pantelis
Papaargyris i datëlindjes
09/02/1984, shtetas Grek, me ID
AP 076311

Deklarojmë se aktiviteti i shoqërisë "**DBI AUDIO & VISUAL ALBANIA**"
shpk, do të rregullohet, organizohet dhe zhvillohet në përputhje me kërkesat e
Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

- 1) **Ky Akt-Themelimi dhe Statuti** bashkalidhur, janë përgatitur në bazë
të kërkesave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe
shoqëritë tregtare" dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.



2) Kohëzgjatja e aktivitetit fiksohet për një periudhë kohe të pakufizuar.

3) Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Organizim të eveneve muzikore, kulturore, sociale etj. Import, eksport të automjeteve dhe mjeteve të rënda. Shitje, blerje, dhënie me qera të aktiveve të shoqërisë mëmë.

4) Për përbushjen e objektit të veprimtarisë, shoqëria mund të marrë pjesë në bashkëpunim me shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjtë ose te përafërt me të saj dhe mund të kryejë direkt apo indirekt të gjitha operacionet e nevojshme për realizimin e objektit te saj.

Shoqëria mund të hapë dhe të mbajë llogari rrjedhëse në lekë apo valuta të tjera, pranë bankave shqiptare apo të huaja, duke mundur gjithashtu të disponojë lirisht mjetet monetare të akumuluara në to, në bazë të legjislacionit në fuqi.

5) Selia e shoqërisë është në adresën: Lagjia 14, Ruga Barjam Tusha, ZK 8516, Shkozet, Durrës. Asambleja si dhe organet e administritmit, kanë kompetencë të hapin filiale e agjensi të tjera dhe t'i mbyllin, sipas çmuarjes dhe gjykimit, që ato i bëjnë cdo rasti.

6) Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet vetëm nga kontributet në para dhe është 10.000 lekë. Ky kapital është i ndarë në 1 kuotë (një) kuotë me vlerë nominale respektive 10.000 lekë.

Kuota në përqindje e ortakut në kapitalin themeltar të shoqërisë është si më poshtë:

-Shoqëria **DBI AUDIO & VISUAL I.K.E.**, zotëron 1 kuotë, 100% të kapitalit themeltar me vlerë 10.000 lekë.

7) **Administratori i shoqërisë**, emërohet për një periudhë kohe 5 (pesë) vjecare me të drejtë riemërimi është:

Z. Pantelis Papaargyris i datëlindjes 09/02/1984, shtetas Grek, me ID AP 076311, i cili ka të drejtën e firmës dhe të përfaqësimit të shoqërisë.

Administratori gjëzon kompetenca të pakufizuara për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që janë ngarkuar asamblesë së përgjithshme.

Në përbushje të detyrës së tij mund të verë në lëvizje instanca juridike dhe administrative, duke emëruar avokatë e duke lëshuar prokura në raste gjyqesh, të kryejnë operacione bankare, përfshirë këtu edhe hapjen e llogarive rrjedhëse, nënshkrimin dhe xhirimin e çeqeve, realizimin e terheqjeve dhe derdhjeve me lekë ne dorë apo urdhër-xhirimi, tituj krediti, paradhënie krediti.

Administratori në përfundim të cdo viti ekonomik përpilon një relacion mbi aktivitetin e zhvilluar, objektivat e arritura dhe perspektivën e shoqërisë, si dhe përgatit bilancin përfundimtar që ia paraqet cdo vit Asamblesë për aprovim.

8) **Viti ekonomik** fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti.

9) **Vlera e kontributit dhe kuotat e ortakëve** shënohen në një libër të posacëm të shoqërisë.

Në përfundim të vtit ekonomik, pas aprovimit të bilancit, Asambleja pasi ka ndarë fondet për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve, detyrimet fiskale ndaj shtetit, rezervat e detyrueshme, vendos për ndarjen e fitimit neto. Për humbjet përgjigjet eksluzivisht shoqëria me kapitalin e saj.

10) **Ortaku** mund ta zmadhojnë kontributin e tij dhe si pasojë edhe kuotën e tij, duke depozituar fitimet e realizuara nga aktiviteti i shoqërisë, konform asaj së parashikuar në Statutin e shoqërisë.

11) **Ortaku dhe Administratori** janë të detyruar të ruajnë sekretin mbi dokumentacionin dhe të dhënat, njohuritë dhe eksperiencat e fituara gjatë

aktivitetit të shoqërisë, dhe marrin të gjitha masat e nevojshme të sigurisë për të evitar përhapjen, qoftë edhe pjesërisht.

Ata janë përgjegjës për pasojat negative që mund të vijnë nga shkelja e dispozitës së mësipërme. Për sa cituar më lart vlen edhe për Audituesin Ligjor.

Ortaku është përgjegjës, ndaj të tretëve për dëmet që mund t'u shkaktohen nga anullimi apo deklarimi i pavlefshëm i këtij akti themelues.


Për sa nuk specifikohet shprehimisht në këtë akt, vlejnë normat e Statutit bashkangjitur.

Njëkohësisht me nënshkrimin e këtij Akti, ortaku nënshkruan edhe Statutin e shoqerisë "**DBI AUDIO & VISUAL ALBANIA**" shpk, i cili i bashkalidhet aktit të themelimit dhe është pjesë përbërëse e tij.

ORTAKU I SHOQËRISË

DBI AUDIO & VISUAL I.K.E

Përfaqësuar nga z. Pantelis Papaargyris

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Pantelis Papaargyris". The signature is fluid and cursive, with "Pantelis" on the left and "Papaargyris" on the right, connected by a diagonal line.